



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
BASHKIA HIMARË

Himarë, më 10.12.2024

Lënda: Kthim përgjigjeje të kërkesës suaj për informacion në platformën elektronike e-mail datë 04.12.2024.

Në përgjigje të kërkesës suaj të dates 04.12.2024 ardhur me postë elektronike (e-mail) , ku kërkohet “Kërkesë për informacion” pranë Bashkisë Himarë. Për sa më sipër po ju përgjigjemi pyetjeve sipas renditjes së bërë në kërkesën tuaj:

- 1) Sa dhoma për intervistimin e të miturve në konflikt me ligjin janë ngritur në bashkinë tuaj dhe ku ndodhen ato?

-Në Bashkinë Himarë është një dhomë intervistimi për të miturit në konflikt me ligjin të parashikuar sipas marrëveshjes mes Ministrisë së Drejtësisë.

- 2) A ka pasur investime për përmirësimin e infrastrukturave që ofrojnë masat alternative për të mitur në bashkinë tuaj? Ku është investuar dhe sa?

-Është parashikuar investime në përmirësimin e dhomës së intervistimit për të miturit.

- 3) Sa të mitur në konflikt me ligjin kanë marrë masa alternative në bashkinë tuaj, për çdo vit, nga firmosja e marrëveshjes deri me 2024, duke përfshirë ata që janë nën 14 vjeç dhe ata që janë rikthyer në sistemin e drejtësisë penale?

-Nga firmosja e marrëveshjes deri tani janë 4 të mitur që kanë marrë masa alternative.

- 4) Sa qendra multifunksionale ka kjo bashki dhe ku ndodhen ato?

-Nuk ka asnjë qendër multifunksionale në territorin e Bashkisë Himarë.

- 5) Sa nga qendrat multifunksionale janë adaptuar pas firmosjes së marrëveshjes për të ofruar shërbime për të miturit në konflikt me ligjin, për rehabilitim, mbikëqyrje dhe edukim?

-Asnjë qendër nuk është adaptuar për tu përshtatur marrëveshjes për të miturit.

- 6) Sa janë kostot e investuara nga bashkia për riadaptimin e këtyre qendrave multifunktionale nga firmosja e marrëveshjes, deri më 2024 për çdo vit?

-Nuk ka qendra dhe rrjedhimisht nuk ka investime.

- 7) Çfarë lloj shërbimesh ofrohen në këto qendra për të miturit, përfshirë mbështetje psikosociale, arsimore dhe rehabilituese?

-Nuk ka.

- 8) Sa punonjës social të trajnuar për të ndjekur të miturit në konflikt me ligjin ka bashkia juaj në 2024?

-Bashkia e Himarës ka 1 punonjës social.

- 9) Sa të mitur janë dënuar me burgim në Bashkinë Himarë dhe sa janë përfshirë në shërbim prove ose masa alternative nga firmoja e marrëveshjes deri më 2024, për çdo vit?

-Asnjë fëmijë nuk është dënuar me burgim ndërsa më masë alternative 1.

- 10) Sa të mitur nën 14 vjeç janë dënuar me burgim në Bashkinë Himarë dhe sa janë përfshirë në shërbim prove ose masa alternative?

-Asnjë fëmijë nuk është përfshirë me dënim burgu dhe as me shërbim prove ose masë alternative.

- 11) Sa të mitur në konflikt me ligjin nën 14 vjeç janë ndjekur nga punonjës socialë dhe sa janë të përfshirë në programet e mbikëqyrjes dhe rehabilitimit në bashkinë tuaj?

-Të gjithë të miturit që paraqiten pranë Komisarariatit të Policisë Himarë trajtohen për procedura që kanë të bëjnë në konflikt me ligjin janë ndjekur paralelisht dhe nga punonjësi social i njësisë së fëmijës ku mbahet kontakt për këshillim dhe vizita në familje.

- 12) Sa janë të miturit që kanë ndjekur programet e rehabilitimit pas përfundimit të dënimit dhe sa të mitur nga bashkia juaj janë recidivist?

-Dy prej të rriturve janë recidivist për arsye të ndryshme familjare dhe probleme socio-ekonomike. Ndërsa 9 të tjerë janë trajtuar dhe rehabilituar për trajtimin e rasteve.

- 13) A keni akses në databazën kombëtare për ndjekjen e rasteve të të miturve në konflikt me ligjin?

-Jo, nuk kemi akses në databazën kombëtare për ndjekjen e rasteve.

- 14) Si komunikon me databazën kombëtare për të miturit në konflikt me ligjin Bashkia

Himarë?

-Bashkia Himarë raporton vazhdimisht mbi rastet tek Agjencia Kombëtare e të Miturve duke referuar mbi specifikat e secilit rast.

15) Sa raste të të miturve në konflikt me ligjin janë regjistruar në bashkinë tuaj në 5 vitet e fundit?

-Janë regjistruar në 5 vitet e fundit 11 raste.

16) A ka bashkia juaj një sistem të vetin për monitorimin e masave alternative për të miturit në konflikt me ligjin?

-Bashkia e Himarës nuk ka një sistem monitorimi për masat alternative për të miturit në konflikt me ligjin.

17) Cilat projekte janë realizuar që nga firmosja e marrëveshjeve për drejtësinë alternative për të miturit? Sa kanë qenë kostot e investuara dhe a janë akoma funksionale?

-Bashkia e Himarës nuk ka projekte mbi marrëveshjen e drejtësisë alternative por ka projekte të cilat lidhen me ndërgjegjësim-informim për shkeljet që janë në kundërshtim me ligjin.

18) Sa fonde janë alokuar nga buxheti i bashkisë për zbatimin e këtyre projekteve?

-10.000.000 lek janë alokuar nga buxheti i Bashkisë për zbatimin e këtyre projekteve.

19) Sa të mitur kanë kryer masa alternative në bashkinë tuaj që prej vitit 2018 për çdo vit?

-Në bashkinë Himarë 4 të mitur kanë kryer masa alternative që prej vitit 2018 cdo vit.

20) Sa efektive është komunikimi mes njësive administrative të bashkisë dhe qendrave multifunksionale të adaptuara për drejtësinë alternative për të mitur? Sa raste nga firmosja e marrëveshjes nga bashkia juaj deri më sot janë transferuar nga njësia bashkiake drejtë qendrave multifunksionale të adaptuara për drejtësinë alternative për të miturit?

-Komunikimi midis njësive dhe bashkisë është goxha efektiv dhe ka një koordinim të mirë mes rasteve të paraqitura për të miturit që kanë nevojë për përkrahje sociale.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin!